**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

# Raporti Vjetor Financiar

## Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

Shkurt 2022

| Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore | Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës |
| --- | --- |
| | |

# Përmbajtja

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE ... - 3 -
Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme ... 4
Raporti i ekzekutimit te buxhetit ... 5
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare ... 6
Shënimi 1 Politikat kontabël ... 6
Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit ... 26
Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale ... 28
Shënimi 2 Paga dhe rroga ... 28
Shënimi 3 Mallra dhe shërbime ... 29
Shënimi 4 Shpenzime komunale ... 31
Shënimi 5 Subvencione dhe transfere ... 31
Shënimi 6 Shpenzime kapitale ... 32
Shënimi 7 Tjera ... 32
Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve ... 33
Shënimi 12 Tjera ... 35
Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta ... 35
Neni 16 Raport për të arkëtueshmet ... 36
Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara ... 37
Neni 18 Detyrimet kontingjente ... 37
Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare ... 37
Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara ... 39
Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara ... 40
Neni 22 Raport për bilancet e pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim ... 40
Neni 23 Raport për të hyrat e dedikuara ... 40
Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara ... 40
Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave ... 40
Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave ... 42
Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime te veçanta ... 42
Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit ( ZKA) ... 43

## Neni 12
# DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **ENVER FEJZULLAHU, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

**FATON FETOSHI, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.

- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.

- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2021.

- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.

- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.

- Të gjitha huatë e pranuara janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi

- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 të Akademisë së Drejtësisë.

**Data: __/__/_____** **Datë: __/__/_____**



_________________ _________________

***(Nënshkrimi i ZKA)*** ***(Nënshkrimi i ZKF)***

## Neni 13

# Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

**Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Akademinë e Drejtësisë**

**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021**

| | Shënim | 2021 | 2020 | 2019 |
|---|---|---|---|---|
| | | **Llogaria e vetme e Thesarit** | **Llogaria e vetme e Thesarit** | **Llogaria e vetme e Thesarit** |
| | | **BKK** '000 | **BKK** '000 | **BKK** '000 |
| **BURIMET E FONDEVE -PRANIMET** | | | | |
| Granti qeveritar | | 489 | 449 | 554 |
| Të hyrat vetanake | | | | |
| Të hyrat e dedikuara | | | | |
| Të hyrat nga AKP | | - | - | 550 |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | | 12 | 6 | 13 |
| Klauzola e investimeve | | | | |
| Fondi zhvillimor në mirëbesim | | | | |
| Pranimet tjera | | | | |
| **Gjithsej** | | **501** | **454** | **1,117** |
| **SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT** | | | | |
| Operacionet | | | | |
| Paga dhe rroga | 2 | 212 | 219 | 196 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 281 | 228 | 351 |
| Shpenzime komunale | 4 | 7 | 7 | 9 |
| | | 501 | 454 | 555 |
| Transferet | | | | |
| Transfere dhe subvencione | 5 | | | |
| Shpenzime kapitale | | | | |
| Prona, ndërtesa dhe pajisje | 6 | | | 562 |
| Pagesa tjera | 7 | | | 1 |
| | | | | - |
| **Gjithsej** | | **501** | **454** | **1,117** |

***Shënim:*** *Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019.*

## Neni 14
# Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Akademinë e Drejtësisë

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

| | | 2021 | | | | 2020 | 2019 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Realizimi | Buxheti final | Buxheti fillestar | Varianca | Realizimi | Realizimi |
| | | A | B | C | D=B-A | E | F |
| | Shënime | € '000 | € '000 | € '000 | % | € '000 | € '000 |
| HYRJA E PARASË SË GATSHME | | | | | | | |
| Të hyrat tatimore | 8 | | | | #DIV/0! | | |
| Të hyrat nga AKP | 9 | | | | #DIV/0! | - | 550 |
| Të hyrat e dedikuara | 10 | | | | #DIV/0! | | |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | 11 | 7 | 7 | | 100.00% | 15 | 15 |
| Tjera | 12 | | | | #DIV/0! | | |
| **Gjithsej Pranimet** | | **7** | **7** | | **#DIV/0!** | **15** | **565** |
| DALJA E PARASË SË GATSHME | | | - | | #DIV/0! | | |
| Paga dhe rroga | 2 | 212 | 213 | 263 | 99.91% | 219 | 196 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 281 | 328 | 536 | 85.66% | 228 | 351 |
| Shpenzime komunale | 4 | 7 | 7 | 17 | 100.00% | 7 | 9 |
| Transfere dhe subvencione | 5 | - | 0 | - | #DIV/0! | - | - |
| Shpenzime kapitale | 6 | | - | - | #DIV/0! | - | 562 |
| Tjerat | 7 | | - | | #DIV/0! | - | 1 |
| **Gjithsej pagesat** | | **501** | **548** | **816** | **#DIV/0!** | **454** | **1,117** |

## Neni 15
## Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

## Shënimi 1 Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116,Ligjin nr. 04/L-194,Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

### 1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Akademia e Drejtësisë ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116,Ligjin nr. 04/L-194,Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës se Kosovës behën përmes Llogarisë se Vetme te Thesarit.

Me Ligjin Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë (AD), Akademia themelohet si institucion publik i pavarur, funksionet kryesore të të cilit janë, hartimi i programit trajnues dhe organizimi i trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, trajnimin për avokat shtetëror, avokatë dhe profesionet e tjera të lira, zhvillimin e procesit të vlerësimit të nevojave për trajnime, kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore, kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira, si dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

AD organizon trajnime me standarde të larta profesionale dhe me metoda efektive në ngritjen e kapaciteteve të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës, duke përfshirë edhe fushën e publikimeve dhe hulumtimeve të cilat kanë në fokus mandatin ligjor dhe përfituesit e AD-së.

Organet kryesore të AD-së janë: Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv, ku përgjegjësitë e të cilëve janë të përcaktuar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Në kuadër të strukturës së brendshme organizative të AD-së, përveç Këshillit Drejtues si organ udhëheqës dhe Këshillit Programor si organ profesional dhe këshillëdhënës, përfshihet edhe Zyra e Drejtorit të AD-së, Departamenti i Programeve dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.

Aktualisht AD, realizon funksionet ligjore në bazë të tri programeve kryesore të cilat operojnë në kuadër të Departamentit të Programit: Programi për Trajnime të Vazhdueshme, Programi për Trajnime Fillestare dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime.

Në kuadër të këtyre programeve trajnuese përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe aktet tjera normative, e të cilat paraqesin mandatin e Akademisë.

- **Misioni**

Akademia ofron trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

- **Vizioni**

Akademia është institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

## 1.2 Programi i Trajnimit Fillestar[1]

Akademia e Drejtësisë në kuadër të mandati të saj, organizon trajnimin fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar.

Programi i trajnimit fillestar (më tutje PTF) zgjatë 12 muaj dhe organizohet sipas kësaj strukture: model i kombinuar i teorisë dhe praktikës ku përfshihen të gjitha degët e së drejtës dhe ligjeve vendore, Acuquis Communautarie, Konventa Evropiane për të Drejta e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare po ashtu përfshinë edhe trajnime me karakter interdisplinar dhe shqyrtimin e rasteve nga praktika gjyqësore, zhvillimi i shkathtësive në përfaqësim, simulime etj.

Ndërsa pjesa e dytë, trajnimi praktikë zhvillohet në gjykata/prokurori ku ata janë emëruar dhe përfshinë aspektet praktike të punës së gjyqtarit/prokurorit ku fokusohet në zhvillimin e shkathtësive praktike me qëllimi të aplikimit të tyre pas përfundimit të

[1] Neni 19 Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë

trajnimi. Gjithashtu sipas programit trajnues gjatë këtij trajnim realizohen vizita në institucionet jo gjyqësore që lidhën me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Programi trajnues është miratuara nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, sipas këtij programi, trajnimi teorik është i ndarë në sesione dhe realizohet përmes shtatë (7) moduleve trajnues bazë, e të cilat përbëhen nga gjithsejtë (49 nën-module). Trajnimi praktik realizohet në gjykata dhe prokurori ku ata janë emëruar nën mbikëqyrje e mentorit, ndërsa AD monitoron këtë proces. Gjithashtu pjesë përbërëse e programi trajnues janë edhe vizitat/trajnimet në institucione jo gjyqësore të cilat kanë për qëllim të ju ofroj njohuri gjyqtarëve/prokurove të shtetit të sapo emëruar me legjislacionin dhe praktikat që zbatojnë institucionet shtetërore gjatë punës së tyre, si dhe aktivitete që kryejnë këto institucionet, të ndërlidhura me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

## Aktivitetet e realizuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar ( PTF) gjatë viti 2021

Trajnimin fillestar gjatë vitit 2021, e ka ndjekur 24 gjyqtarë të sapo emëruar ku dy prej tyre të minoritetit serb dhe me suksese janë përmbushur objektivat e përcaktuar në Planin e Punës dhe Programin Trajnues. Gjatë vitit 2021 gjendja pandemike, ka qenë sfide në zbatimin e metodologjisë trajnues për disa aktivitetet konkrete. Në këtë drejtim Akademia e Drejtësisë i ka ndërmarrë veprime në bazë të vendimeve dhe udhëzimeve të organeve kompetente për mbrojtje nga pandemia, dhe ka hartuar planin për menaxhimin e situatës dhe masave preventive të virusit COVID-19, duke mundësuar realizimin e trajnimeve në të njëjtën kohë sipas planifikimit të kalendarit trajnues, duke zbatuar metodologjinë e kombinuar në mënyrën fizike dhe atë virtuale.

## Gjenerata e tetë e gjyqtarëve të sapo emëruar (2020-2021)

Gjenerata e tetë e gjyqtarëve të sapo emëruar, ka filluar trajnimin fillestar me 18 shkurt 2021, programi trajnues është dizajnuar dhe përshtatur masave për parandalimin e COVID -19 dhe në total janë realizuara 197 aktivitete trajnuese prej tyre 113 ditë trajnimi teorik dhe 84 ditë trajnimi praktik.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive, Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe akteve të tjera ndërkombëtare. Sipas programit trajnues fillestar për gjyqtarët janë realizuar shtatë (7) module trajnuese (të cilat përbëhen nga 49 nën module). Në trajnimin teorik për gjyqtarët në total janë realizuar 113 ditë trajnimi, 226 sesione
trajnuese apo 678 orë trajnimi.

| Programi për Trajnimin Fillestar 2021[2] | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjyqtarë të sapoemëruar** | Gjinia | | Përkatësia Etnike | | | Totali i ditëve të trajnimit | Ditë trajnimi teorik | Ditë trajnimi praktik | Sesionet Trajnuese | Orë Trajnimi | Trajner të angazhuar | Mentor të angazhuar |
| | M | F | SH | SR | TJ | | | | | | | |
| **24 Gjyqtarë** | **16** | **8** | **22** | **2** | **0** | **197** | **113** | **84** | **226** | **678** | **38** | **44** |

## 1.3 Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

Në ligjin për Akademinë e Drejtësisë vend shumë të rëndësishëm zë Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm. PTV organizon aktivitetet trajnuese për gjyqtarë, prokurorë, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe përfitues tjerë sipas ligjit të Akademisë së Drejtësisë përmes të cilave siguron standarde të larta të cilësisë së trajnimit gjyqësor.

Në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme, janë realizuar trajnime si nga aspekti material ashtu edhe ai procedural. Temat që trajtohen në kuadër të PTV janë tema të karakterit profesional-ligjor dhe tema të karakterit interdisiplinar. Strukturat e PTV është e përberë nga lëmia e së drejtës penale, lëmia civile, drejtësia për fëmijë - aspekti civil dhe penal, drejtësia komerciale, trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut – KEDNJ, trajnimet nga e drejta e Bashkimit Evropian, e drejta kushtetuese, lëmia për kundërvajtje, trajnimet për mos diskriminim, trajnimet e Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme, e drejta administrative si dhe Kompetenca interdiciplinare.

Sfiduese për Akademinë e Drejtësisë në realizimin dhe zbatimin e Programit Trajnues 2021, ka qenë situata e shkaktuar nga pandemia COVID 19. Duke u bazuar në rekomandimet e OBSH-së dhe institucioneve tjetra relevante të Kosovës, numri më i madh i aktivitete trajnuese të planifikuara sipas kalendarit trajnues janë realizuar përmes platformave të ndryshme elektronike çofshin ato drejtpërdrejtë apo dhe përmes platformës së mësimit në distancë E-learning. Gjatë vitit 2021 në mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë në programet e Akademisë së Drejtësisë janë realizuar disa aktivitete trajnuese në mënyrë fizike dhe atë hibride ( duke i kombinuar me pjesëmarrje fizike dhe përmes platformës zoom). Një numër i konsiderueses i trajnimeve janë realizuar në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë duke kombinuar kështu ekspertize vendore me atë ndërkombëtare me

[2] Trajnimi fillestar ka filluar në vitin 2021 dhe një pjesë e programit trajnues do të realziohet gjatë vitit 2022 (shih Programin trajnues per gjyqtarët e sapo emëruar 2021/2022)

ç'rast i kanë bëre edhe me të fuqishme trajnime e realizuar në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm.

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2021, në kuadër të PTV-së janë realizuar 128 aktivitete trajnuese. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këto aktivitetet trajnuese ishte 3987, prej tyre 2992 kanë qenë gjyqtarë, 723 prokurorë dhe 272 profesionist tjerë.




**Grafikoni Nr.1. i Trajnimeve dhe pjesëmarrësve të realizuar për periudhën janar-dhjetor**




Grafikoni Nr.2. Numri i Trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave për periudhën Janar-Dhjetor 2021

Numri i Trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave për periudhën janar-dhjetor 2021

- Penale - 47
- Civile - 23
- Drejtësia për Fëmijë – Penale - 7
- Drejtësia për Fëmijë – Civile - 1

- Ekonomike - 12
- Ndërmjetësimi - 1
- Administrative - 8
- Kundërvajtje - 1
- Kushtetuese -1
- Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme - 4
- KEDNJ - 11
- Interdisiplinare - 6
- E drejtë e BE-së - 3
- Kundër diskriminimit – 3

**Numri i Trajnimeve të realizuara në PTV në Bashkëpunim me Donatorët 2021**

| Nr. i trajnimeve të realizuara nga Akademia e Drejtësisë në Bashkëpunim me Donatorët 2021 PTV | Nr. i Trajnimeve |
|---|---|
| Akademia e Drejtësisë | 72 |
| Mbështetje të Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit për Ndihmë Shtetërore | 1 |
| Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) | 2 |
| Ambasada Amerikane | 3 |
| AXIOM International - Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar | 2 |
| Banka Botërore | 1 |
| Bashkimi Evropian - Mbështetja e Kodit Civil Faza 2 | 6 |
| CEL (Center for Equality and Liberty Kosova ) | 2 |
| EIPA | 2 |
| EULEX | 1 |
| GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) | 5 |
| ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës | 1 |
| IPROCEEDS | 1 |
| IRZ (German Foundation for International Legal Cooperation) | 2 |
| Këshilli i Evropës - Forcimi i institucioneve të Kosovës në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimeve tjera degraduese | 3 |
| Këshilli i Evropës - JUFREX (Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe) | 3 |
| OSBE | 6 |
| UNDP | 3 |
| UNHCR | 1 |
| USAID / Drejtësia Komerciale | 11 |
| **Gjithsej trajnime** | **128** |

## Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial luajnë rol kyç në përmirësimin e efikasitetit të punës së gjykatave dhe prokurorive. Programi i trajnimit të stafit administrativ synon ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në gjykata dhe prokurori. Përfitues të trajnimeve janë bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjorë, administratorët dhe ndihmës administrator, kategori që kontribuojnë në zhvillimin e një administrate moderne, profesionale, efektive dhe transparente. Kategori tjetër përfituese janë: shefat e zyrave për menaxhimin e lëndëve, zyrtarët për informimi, referentet, zyrtarët e statistikave dhe sekretarët juridike.

Numri me i madhe i trajnimeve për stafin administrativ janë realizuar online për shkak të situatës se krijuar nga COVID 19.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2021, Akademia e Drejtësisë për ketë kategori përfituese, ka realizuar 12 aktivitetet si më poshtë:

- Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor - 1
- Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin prokurorial - 1
- Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun - Stafi i gjykatave - 1
- Komunikimi me marrëdhëniet me publikun - 1
- Integriteti dhe sjelljet etike - Stafi i gjykatave dhe prokurorive - 1
- Risitë në kompetencat dhe strukturën organizative dhe menaxheriale në sistemin gjyqësor -1
- Risitë në kompetencat dhe strukturën organizative dhe menaxheriale në sistemin prokurorial - 1
- Shkrimi dhe arsyetimi ligjor - Stafi i gjykatave dhe prokurorive - 1
- Trajnim në përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) - 2 ditë
- Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor - 1
- Menaxhimi i punës në administratën e sistemit prokurorial - 1
- Menaxhimi i kohës dhe stresit - 1




Grafikoni Nr.3. Numri i Trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave për periudhën janar-dhjetor 2021

## Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ ka realizuar dy aktivitetet trajnuese me zyrtarë për Ndihmë Juridike Falas si në vijim:

- Barazia gjinore në çështjet pronësore të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve - 1
- E drejta sendore - çështjet pronësore - 1




Grafikoni Nr.4. Numri i Trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave për periudhën janar-dhjetor 2021

## Trajnimet e Trajnuesve për vitin 2021

Akademia e Drejtësisë, përveç trajnimeve për Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ të Gjykatave dhe Prokurorive, gjithmonë ka pasur për qëllim edhe ngritjen e shkathtësive dhe metodologjive trajnuese për trajnuesit e saj.

Kjo gjë është reflektuar edhe gjatë vitit 2021, ku si asnjëherë më parë ka pasur ngritje të numrit të Trajnimeve për Trajnues (**10**) gjithsej, për të vetmin qëllim që trajnuesit e AD-së të aftësohen dhe të jenë në hap me përditësimet e fundit në metodologjitë trajnuese dhe ndryshimet legjislative.

Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar trajnimet e trajnuesve si rrjedhojë e vlerësimit të nevojave dhe të dalurat nga trajnimet me gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive. Për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të trajnimit, të gjitha trajnimet e trajnuesve gjatë vitit 2021 janë zhvilluar në bashkëpunim me donatorët e Akademisë së Drejtësisë, të cilët përveç mbështetjes teknike, kanë pasuruar trajnimet edhe me ekspert dhe trajnues ndërkombëtar, të cilët me përvojën dhe njohuritë e tyre ishin një aset i çmuar për trajnuesit vendorë të AD-së.

**Gjatë vitit 2021 janë realizuar këto Trajnime për Trajnues:**

1. Në vitin 2021 ka vazhduar procesi i rekrutimit të Trajnuesve në fushën e **Drejtësisë Komerciale**, i nisur që nga Nëntori i vitit 2020, në bashkëpunim me Checchi&Company Consulting Inc., si implementuese e Programit për Drejtësi Komerciale brenda Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Programi trajnues ishte i ndarë në 3 sesione trajnuese, me nga 4 ditë, 2 prej të cilave u zhvilluan në Janar të vitit 2021 dhe tjetra në Mars 2021.
   Pas përfundimit të trajnimit të trajnuesve, si pjesë e programit trajnues ishin edhe zhvillimi i pilot trajnimeve nga të gjithë kandidatët. U zhvilluan 10 pilot trajnime ku pas të cilave rezultoi me çertifikimin e 17 kandidatëve të cilët do të jenë trajnues të ardhshëm brenda AD-së në fushën e të drejtës Ekonomike dhe Komerciale.

2. **Lufta Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje** – Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar **2** trajnime të trajnuesve në fushën e Dhunës ndaj grave/dhunës në familje. Të dy trajnimet janë zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin e Evropës me eksperten nga Kanadaja Eline Skinneder. Trajnimi i parë i zhvilluar në Maj 2021, kishte për synim trajnimin e një grupi të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Si përfundim rezultoi me trajnimin e **5** gjyqtarëve dhe **5** prokurorëve të cilët janë si koordinator të veprave që kanë të bëjnë me dhunën në familje nëpër gjykata dhe prokurori.
   Trajnimi i dytë u zhvillua në Qershor 2021 e që për audiencë kishte zyrtarët e Qendrave për punë sociale si dhe organizatat joqeveritare të cilat merren me Dhunën ndaj grave/dhunën në familje. Në trajnimin e dytë u trajnuan **14** pjesëmarrës duke përfshirë zyrtarë policor, zyrtarë nga QPS dhe zyrtarë të OJQ-ve.

3. **Parandalimi i Torturës – Artikulli III i Konventës së Stambollit –** Edhe në fushën e parandalimit të Torturës në vitin 2021 janë zhvilluar **2** trajnime të trajnuesve, në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës Strengthening the Kosovo* Institutions in fight against torture, ill-treatment and other degrading treatment. Të dy trajnimet e zhvilluara në Shtator dhe Tetor 2021, kishin pjesëmarrësit e njëjtë, **3** Prokurorë, **5** gjyqtarë, **3** zyrtarë nga Mekanizmi kombëtar për parandalim të torturës brenda zyrës së Avokatit të Popullit si dhe **3** zyrtarë nga Policia e Kosovës. Qëllimi i trajnimit ishte që të trajnohen një grup i caktuar i pjesëmarrësve duke i përfshirë të gjithë akterët të cilët janë në mënyrë direkte apo indirekte të përballur me rastet e torturës dhe formave tjera të keqtrajtimit.

4. **Financimi i Terrorizmit –** Edhe ky trajnim është zhvilluar në bashkëpunim me Projektin e Këshillit të Evropës (Project against Economic Crime in Kosovo PECK III). Trajnimi i zhvilluar në 19-21 Tetor 2021 si shumica e trajnimeve të trajnuesve përfshiu pjesëmarrës nga institucione të ndryshme. Pjesëmarrësit e trajnuar në këtë trajnim 3 ditor ishin Prokurorë nga Prokuroria Speciale, Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, zyrtarë nga Njësia e Inteligjencës Financiare si dhe zyrtarë policor. Me po të njëjtin projekt AD synon ta vazhdojë bashkëpunimin edhe gjatë vitit 2022 duke e zgjeruar fushën e trajnimit edhe në pjesën e Shpëlarjes së Parave.

5. **Liria e Shprehjes – Neni 10 i KEDNJ** – Trajnimi nga fusha e Lirisë së shprehjes është vazhdimësi e bashkëpunimit të Akademisë së Drejtësisë me projektin e JUFREX nga Këshilli i Evropës. Ky trajnim 4 ditor i realizuar në muajin Tetor, përfshiu 5 gjyqtarë, 4 prokurorë si dhe 5 anëtarë nga Oda e Avokatëve. Qëllimi i trajnimit ishte përgatitja e një kuadri të trajnuesve që do ta mbulojnë pjesën e Lirisë së shprehjes dhe mediave, si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

6. Trajnim i Trajnuesve në fushën e Diskriminimit – Trajnimi është zhvilluar në bashkëpunim me OSCE. Pjesëmarrës të trajnimit ishin 10 Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe Themelore nga regjione të ndryshme. Qëllimi i trajnimit ishte që trajnuesit potencial të AD-së në fushën e Diskriminimit të njoftohen më gjerësisht me format e diskriminimit dhe mënyrat e trajtimit të rasteve, krahasimet legjislative mes Kosovës dhe të drejtës së BE-së, barra e provës në çështjet e diskriminimit etj.

7. Trajnim i Trajnuesve mbi Evidencat Penale – Trajnimi mbi Evidencat penale ishte trajnimi i fundit i trajnuesve i realizuar gjatë vitit 2021. Ky trajnim u realizua në Dhjetor 2021 në bashkëpunim me projektin National Centralised Criminal Record System (NCCR). Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin 7 gjyqtarë dhe 4 prokurorë nga gjykatat dhe prokuroritë themelore nga regjionet e ndryshme.




Grafikoni nr.5 me Trajnimet për Trajnues në periudhën Janar – Dhjetor 2021

**Raporti Vjetor rreth platformës së mësimit në Distancë E-learning**

Akademia e Drejtësisë përveç trajnimeve klasike, që nga viti 2011 ka zhvilluar edhe platformën e mësimit në distancë E-learning. Kjo platformë është krijuar me qëllim të lehtësimit të marrjes së informacionit dhe çasjes më të lehtë për tema të ndryshme për përfituesit e saj (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive) etj.
Platforma E-learning gjatë vitit 2021 është pasuruar me 3 kurse të reja, të zhvilluara në bashkëpunim me organizatën joqeveritare "INJECT". Këto kurse ishin të fokusuara në fushën e dhunës ekonomike dhe formave të ndarjes së bashkëshortëve, tema të cilat janë pak të trajtuara. Gjatë periudhës sa ishin online, në këto kurse u certifikuan 5 Gjyqtarë dhe 1 Prokurore.

Gjithashtu gjatë vitit 2021 janë zhvilluar edhe 2 kurse tjera, njëra në bashkëpunim me projektin e "IPR – Intellectual Property Rights" në fushën e Markave Tregtare, Dizajnit Industrial dhe Markave Tregtare, dhe kursi tjetër i zhvilluar nga Trajnuesi i Përhershëm brenda Akademisë së Drejtësisë me temë "Paraburgimi".
Me qëllim të avansimit dhe ofrimit të kurseve sa më profesionale, Akademia e Drejtësisë ka filluar procesin e kalimit dhe ndryshimit të platformës E-learning nga platforma aktuale ILIAS, në platformën MOODLE. Ky ndryshim është duke u bërë në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, e cila ka shprehur gatishmërinë që ta ndihmojë AD-në në zhvillimin e softwarit si dhe ofrimin e kurseve të tyre nga platforma HELP, me qëllim të pasurimit të platformës së AD-së me kurse të reja dhe profesionale.

Kjo është edhe arsyeja që 2 kurset e zhvilluara në fushën e markave tregtare dhe paraburgimit nuk janë integruar ende në platformë, deri sa të bëhet tërësisht ndryshimi i platformës dhe të adaptohen kurset sipas kërkesave teknike të platformës Moodle.
Më tërë këto ndryshime, Akademia e Drejtësisë synon që platformën e saj elektronike E-learning ta bëj një burim të rëndësishëm të informacionit, duke e pasuruar dhe zhvilluar sipas metodave më të avansuara, me qëllim që përfituesve të saj të ju ofrohen kurse profesionale dhe të nevojshme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Gjatë vitit 2021, në kuadër të platformës së mësimit në distancë E-learning, janë ofruar këto kurse trajnuese:

1. Dhuna Ekonomike;
2. Mbajtja financiare dhe Alimentacioni;
3. Ndarja e pasurisë së përbashkët mes bashkëshortëve.

Kurset që janë zhvilluar por pritet të integrohen pas kalimit në platformën MOODLE:

1. Markat Tregtare, Patentat, Dizajni Industrial;
2. Paraburgimi.




Grafikoni nr.6 me Kurset në platformën E-learning dhe numrin e Pjesëmarrësve në vitin 2021

## 1.4 Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)

Ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve, prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit të AD-së bëhet edhe përmes vlerësimit të nevojave trajnuese dhe zhvillimit të programeve trajnuese adekuate. Gjithashtu krahas burimeve primare për lehtësimin e procesit të bërjes së drejtësisë edhe përmes krijimit mjeteve juridike dhe ofrimit të burimeve të cilat realizohen përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime.

Pra, për zhvillimin profesional ky program kryen analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

### Aktivitetet në PHP

Në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete të cilat kanë qenë të orientuara në drejtim të:

- Zbatimit të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe përpunimit të dhënave për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2022;
- Veprimtarisë botuese me theks te zhvillimi i moduleve trajnuese për zbatimin e programeve të AD-së;
- Ofrimit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;
- Aktiviteteve në procesin e planifikimeve institucionale në zbatim të masave dhe politikave euro integruese si dhe
- Menaxhimit të koleksioneve të bibliotekës dhe abonimit në data baza elektronike.
- Përditësimit të statistikave dhe data bazës me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së.

### Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë vëmendje të veçantë i ka kushtuar vlerësimit të nevojave trajnuese, meqë nga rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces, përfshirë edhe zhvillimi i metodologjisë trajnuese janë përcaktuese për kurrikulën trajnuese të radhës. Në këtë vështrim, procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese është realizuar duke i zbatuar me efikasitet mekanizmat për vlerësim gjatë gjithë vitit duke analizuar gjitha burimet e informacionit dhe zhvillimet e reja në gjyqësor. Pra, në funksion të vlerësimit të nevojave trajnuese në periudhën raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga analiza e formularëve të vlerësimit pas secilit sesion trajnues deri në fund të vitit 2021;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga pyetësorët për gjyqtarë dhe prokurorë

- Identifikimi i nevojave trajnuese përmes realizimit të takimeve me trajnues të AD-së, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë mbikëqyrës si dhe përfaqësues nga KGJK dhe KPK
- Shqyrtimi i propozimeve dhe rekomandimeve nga dokumentet strategjike të cilat kanë relevancë për gjyqësorin duke përfshirë edhe raportin e BE-së për Kosovën dhe kërkesat e MSA-së.
- Shqyrtimi i portaleve të gjykatave dhe prokurorive duke marrë për bazë edhe raportet e punës së tyre;
- Për çështje krahasimore janë shqyrtuar edhe programet trajnuese të institucioneve trajnuese rajonale si dhe
- Në vazhdimësi është përcjellë agjenda legjislative në kuvend si dhe mediat dhe portalet të cilat kanë pasur në fokus gjyqësorin e Kosovës.

Mbledhja dhe përpunimi i këtyre të dhënave nga këto burime është finalizuar me *Raportin analizë nga vlerësimi i nevojave trajnuese për vitin 2022* i cili më pas i ka kontribuar hartimit të Programit trajnues për vitin 2022.

### Veprimtaria botuese

Komponentë e rëndësishme e Programit për Hulumtime dhe Publikime është edhe veprimtaria botuese. Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë është angazhuar në procesin e nxjerrjes dhe shtypjes së botimeve duke qenë në kontakt dhe monitoruar procesin deri në finalizimin e tyre.

Gjatë vitit 2021 për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë realizuar publikimet si në vijim:

- Plani i performancës dhe i punës për vitin 2021 i AD-së
- Raporti vjetor i AD-së për vitin 2020
- Programi i Trajnimit për vitin 2022
- Manuali për gjyqtarë për procedurën e falimentimit
- Manuali për administratorë për procedurën e falimentimit
- Manual Trajnimi për Trajnerë për Prokurorë dhe Gjyqtarë: Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
- Kurrikula model mbi Protokollin e Stambollit - Hetimi dhe Dokumentimi Efektiv i Torturës dhe Keqtrajtimit
- Material Burimor për prokurorët dhe gjyqtarët në luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

- Modul trajnimi për gjyqtarë dhe prokurorë-Situata dhe trajtimi i rasteve të abuzimit ekonomik të fëmijëve
- Udhëzues për procedurat dhe mënyrën e trajtimit të viktimave të krimit
- Moduli i trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive –aspekti penal, material dhe procedural
- Moduli i trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive –aspekti civil, material dhe procedural

Kjo komponentë, veçanërisht publikimet që kanë karakter udhëzues për gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor është mbështetur nga projektet me donatorë si UNDP, SAEC, Këshilli i Evropës. ILO ( Organizata ndërkombëtare e Punës), GIZ, IFC dhe USAID.

Ekzemplarët e shtypur nga botimet e lartpërmendura janë shpërndarë tek përfituesit e AD-së me theks te gjyqtarët, prokurorët si dhe profesionistët ligjor që puna e tyre lidhet me përmbajtjen që ofrojnë botimet përkatëse.

Për nevojat e zbatimit të Programit të Trajnimit fillestar janë realizuar edhe 6 modulet trajnuese për 34 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII konform këtij programi të cilat përfshijnë aspektin profesional dhe interdisciplinar.

## Aktivitetet në mbështetje të mekanizmave euro integrues dhe

Akademia e Drejtësisë ka ofruar kontributin e saj në planifikimin e strategjive që i kontribuojnë sundimit të ligjit. Në këtë vështrim ka qenë pjesë e planifikimit strategjik për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave që do të mbuloj vitin 2022-2026 gjithashtu edhe ka zbatuar aktivitetet që dalin nga kërkesat e dokumenteve tjera strategjike në nivel nacional si dhe të MSA-së dhe raportit të BE-së për Kosovë duke raportuar në baza të rregullta në institucionet dhe mekanizmat përkatës.

Përveç mekanizmave euro integrues, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi ka bashkëpunuar me KGJK dhe KPK dhe njësitë për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime. Gjithashtu për nevoja të raportimit ose edhe të prezantimit institucional në konferenca, takime dhe forma tjera janë nxjerrë të dhëna statistikore për aktivitetet trajnuese dhe detajet tjera që tregojnë

angazhimin e Akademisë në ngritje të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit

## Aktivitetet e bibliotekës së AD-së

**Menaxhimi i koleksioneve të bibliotekës**

